



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

Revista “Syri Ynë”

Botim periodik i Shoqatës së të verbërve të Kosovës

Nr. 20

Dhjetor, 2023



Funded by
the European Union

Ky botim është publikuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj reviste është përgjegjësi e vetme e *Shoqatës së të verbërve të Kosovës* dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Këshilli botues:

Enver Ulaj,
Melihate Pllana,
Bekim Krasniqi
Florian Tishuki.

Përmbajtja

<i>Editorial.....</i>	<i>faqe</i>
<i>Dy fjalë për botimin</i>	<i>faqe</i>
<i>Intervista.....</i>	<i>faqe</i>
<i>Aktivitetet e SHVK</i>	<i>faqe</i>
<i>Hartimi i strategjisë</i>	<i>faqe</i>
<i>Arsimi dhe Shëndetësia në vitin kushtuar personave me aftësi të kufizuara</i>	<i>faqe</i>
<i>Kosova dhe heqja e vizave, udhëzime për vitin 2024.....</i>	<i>faqe</i>
<i>QBMK, aktivitete në përmirësim të arsimit</i>	<i>faqe</i>
<i>Aktivitetet sportive</i>	<i>faqe</i>
<i>Portret sportisti</i>	<i>faqe</i>

Dy fjalë për botimin

Të dashur lexues të revistës “Syri ynë”.

Ky numër i ri revistës sonë periodike është numër dy herë festiv. E para sepse po del në prag të festave të fundit të vitit, krishtlindjeve dhe Vitit të ri. E dyta sepse është numër jubilar me numër 20. Duke qenë numër përmbyllës i vitit, në disa nga shkrimet e saj, revista synon të jetë në përmbledhje të ngjarjeve dhe temave që kanë karakterizuar disa nga fushat e jetës në vitin që lamë pas.

Në këtë qëllim janë marrë disa shkrime që kanë të bëjmë me atë që është përmbledhur dhe raportuar gjatë vitit nga aktivitetet që janë mbajtur në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit. Këto janë tri fushat prioritare ku është përqendruar interesimi dhe angazhimi jonë në përmirësimin e kushteve të personave të verbër në Kosovë.

Gazeta ka rubrikat e veta të përhershme, aktivitetet që ka bërë shoqata e të verbërve të Kosovës, komuniteti, ngjarjet që kanë shënuar jetën e tyre në këtë periudhë, çështjet që prekin legjislacionin dhe ndryshmet të cilat ndikojnë në jetën e personave të verbër, arritjet në arsimim dhe shkollim, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, etj. Është edhe një artikull lidhur me planifikimin strategjik dhe planet për periudhën në vazhdim si dhe një këndvështrim eksperti nga një person i verbër, personaliteti respektuar në çështjet juridike dhe në pozitën e personave të verbër si anëtar i organizatës evropiane të të verbërve, EBU.

Ndërsa sa i përket numrit jubilar, revista “Syri ynë” ka dalë periodikisht dhe mbështetja afatshkurtër nga donatorë që kanë mbështetur një deri në tre numra, jo më shumë. Numri i 20 revistave është një numër shumë i vogël, por duke pasur parasysh mundësitë dhe përkrahjen, ka qenë i vështirë të arrihet për të verbrit në Kosovë. Përkujtojmë se këta numra janë arritur në një periudhë prej disa vjetësh, që tregon se megjithatë ka qenë një rrugë e gjatë dhe fillon më shumë se dhjetë vjet më parë, në numrat e parë që kanë filluar të dalin nga viti 2010. Katër numrat e fundit janë botuar falë mbështetjes nga fondet e Bashkimit Evropian falë organizatës Kosovo 2.0. Ka qenë programi shumë i qëlluar i kësaj organizate me emrin “Diversifikimi i zërave në gazetari” që ka mundësuar zgjatjen e jetës për revistën edhe një periudhë një vjeçare. Mbi këtë program SHVK është një përfituesit e kësaj thirrje për grante për media, që do të ndihmojë në krijimin e një ambienti divers për gazetarinë në Kosovë, ku revista jonë është vlerësuar si një kontribut.

Ekipi që përgatit gazetën shpreson që lexuesit të gjejnë gjëra interesante në këtë numër të revistës. Dhe në këtë fillim të vitit të ri, ju uron një vit të mirë dhe të suksesshëm gjatë vit 2024 për të gjithë lexuesit tonë, vit që të çojë më para sukseset e arritura gjatë këtij viti dhe drejt një jetë më të mirë e më të dinjitetshme.

Intervista: Besnik Bislimi, zëvendës kryeministër i Republikës së Kosovës

Zëvendës kryeministri i Republikës së Kosovës Besnik Bislimi kohë më parë vizitoi qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim Xheladin Deda në Pejë ku o njoh me punën që bëhet në këtë institucion për shkollimin e personave të verbër në Kosovë dhe takoi nxënës dhe mësimdhënës të shkollës. Ne, duke parë angazhimin e Qeverisë së Kosovës për personat me aftësi të kufizuara, i kërkuam një intervistë për revistën tonë. Me gjithë angazhimet e tij si udhëheqës i delegacionit të Kosovës në bisedimet me Serbinë dhe angazhimet tjera në Qeverinë e Kosovës, zëvendëskryeministri Bislimi gjeti kohë t'u përgjigjet pyetjeve tona. Realizimi i intervistë u bë i mundur me ndihmën e këshilltarit të kryeministrit z. Halil Kurmehaj.

Pyetje: Keni vizituar shkollën për të verbër, qendrën Burimore në Pejë dhe keni parë mundësitë e shkollimit dhe arritjet. Cilat janë përshtypjet e juaja pas kësaj vizite?

Përgjigje: Gjatë vizitës së zhvilluar në këtë institucion, jemi inkurajuar nga arritjet dhe vullneti i këtyre të rinjve, ndonëse ata përballen me sfida të ndryshme. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për të adresuar problematikat e çështjet me interes për personat me nevoja të veçanta. Ishte shumë frytdhënëse njohja nga afër me historitë e talentet e secilit e secilës gjatë vizitës në këtë institucionin arsimor të specializuar për nxënësit me nevoja të veçanta. Kjo e rrit inkurajimin tonë, kur shohim edhe arritjet dhe vullnetin e të rinjve. Kujdesi dhe mbështetja për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara është thelbësore për zhvillimin e tyre të suksesshëm dhe integrimin në shoqëri.

Pyetje: Qeveria juaj ka pasur një varg arritjesh në lidhur me personat me aftësi të kufizuara (PAK) si punësimi i asistimeve nëpër shkolla, përgatitja e sintezës vokale në gjuhën shqipe, shpallja e vitit 2022 vit kushtuar personave me aftësi të kufizuara, etj. Cilat janë angazhimet e qeverisë në vazhdim lidhur plotësimin standardeve lidhur me personat me aftësi të kufizuara?

Përgjigje: Së pari, qeverisja jonë është gjithëpërfshirëse dhe kujdeset për trajtimin e nevojave të të gjitha komuniteteve e grupeve shoqërore, përfshirë ato që lidhen me personat me nevoja të veçanta. Së dyti, kemi një inkurajim shtesë për të zhvilluar standarde të reja për këtë kategori, duke i kushtuar veçanërisht vëmendje të rinjve. Sinteza vokale në gjuhën shqipe, ashtu siç është theksuar, paraqet një investim të rëndësishëm nga Qeveria e Kosovës. Ne besojmë se, përmes këtij investimi, nxënësit dhe studentët e verbër do të kenë mundësinë të jenë pjesë aktive e shoqërisë dhe, në të njëjtën kohë, të zhvillojnë potencialet e tyre në mënyrë që të integrohen sa më shumë në shoqëri. Gjithashtu janë ndërmarrë dhe hapa kyç për të përfshirë një nga aktet më të rëndësishme të OKB-së në Kushtetutën tonë. Synimi ynë është të bëjmë amandamentimin e Kushtetutës, duke bërë Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për personat me aftësi të kufizuara pjesë të jetës dhe sistemit juridik dhe institucional të vendit.

Pyetje: Një nga objektivat e vitit kushtuar personave me aftësi të kufizuara ka qenë punësimi bazuar në ligjin për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e PAK, i cili thotë punësimin e një PAK në çdo 50

persona. Kabineti juaj e ka punësuar një person të verbër , por ju personalisht si e shihini gjendjen e punësimit të PAK në Kosovë?

Përgjigje: Punësim dhe drejtësi janë prioritete tona kyçe të qeverisjes. Punësimi për personat me aftësi të kufizuara nuk është thjesht një detyrim ligjor, siç e keni cekur, por një normë që duhet respektuar, përfshirë këtu edhe ligjin për personat e verbër. Punësimi i të rinjve me aftësi të kufizuara ka një rëndësi të veçantë, pasi synojmë që ata të mos jenë barrë për shtetin, por të shërbejnë si potencial për shoqërinë. Qeveria, në përpjekje të vazhdueshme për ringjalljen ekonomike, ka ndërmarrë masa aktive për punësimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për këtë komunitet. Kjo nuk ka qenë një përpjekje e izoluar, por është integruar edhe në legjislacionin bazik. Si shembull konkret, mund të përmendim ligjin për zyrtarët publik, ku është normuar me mënyrë taksative punësimi i këtij komuniteti në administratën shtetërore dhe institucionet tjera. Viti që po vjen do të jetë ende më i begatë për të rinjtë tanë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Në lidhje me personin që është emëruar në kabinetin tim, ai është i emëruar mbi bazën e profesionalizmit, jo për shkak të aftësive të kufizuara apo verbërisë. Shoqëria jonë duhet të besojë dhe insistojë tek mundësitë e barabartë për të gjithë, si vlerë shtesë dhe e çmuar.

Pyetje: Nga muaji janar fillon lëvizja e lirë pa viza në zonën Shengen për qytetarët e Kosovës. Cilat janë përgjegjësitë dhe obligimet që kanë qytetarët e Kosovës dhe a keni paraparë se personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre mund ta keqpërdorin këtë mundësi për të krijuar kushte më të mira dhe trajnim në vendet e BE-së?

Përgjigje: Jemi përkujdesur për të mbuluar një spektër sa më të gjerë të qytetarëve, dhe përqendruar në organizimin e një fushate sensibilizuese gjithëpërfshirëse. Në këtë drejtim, kemi zhvilluar një seri takimesh me shoqatën e personave të verbër, duke krijuar një platformë të hapur ku ata kanë mundësi të informohen më gjerë dhe të shprehin kërkesat dhe nevojat e tyre. Gjithashtu, kemi përgatitur dhe shpërndarë materiale informuese, duke përfshirë broshura të shkruara në shkrimin braj dhe shkrim të zmadhuar, si dhe video sensibilizuese. Këto materiale janë dizajnuar për të bërë maksimumin që informacioni të jetë i arritshëm për personat e verbër. Për të thelluar ndikimin e fushatës sonë, kemi ofruar materialet e përgatitura për shoqatat e personave të verbër, duke i inkurajuar ato që t'i shpërndajnë dhe promovojnë si informacion sa më shumë në rrethin e tyre, në rrjetet sociale dhe mjediset tjera komunitare. Këto hapa janë ndërmarrë me synimin e qartë për të siguruar që të gjithë anëtarët e komunitetit, të kenë mundësinë për të aksesuar informatat e dhëna gjatë fushatës së informimit.

Aktivitetet e SHVK-së nëntor -dhjetor

Pjesëmarrja në festivalin ballkanik të të verbërve në Turqi

11-14 nëntor 2023

Shoqata e të Verbërve të Kosovës me ftesë nga Federata e të Verbërve të Turqisë, dhe me mbështetje të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit ka qenë pjesëmarrëse në festivalin ballkanik të të verbërve me një përfaqësim shumë profesional, me këngëtar dhe me instrumentistë në Kirklareli të Turqisë.

Pjesëmarrës nga Kosova janë këngëtarë të zhanreve të ndryshme të këngës shqipe.

Festivali është mbajtur për 5 ditë radhazi dhe ka qenë në qytete të ndryshme të Turqisë. Me veshja kombëtare dhe çiftelia simbolet tona kombëtare, janë prezantuar në secilin qytet të Turqisë nga këngëtarët tanë nga Kosova.

Kjo është pjesëmarrja e dytë e artistëve të verbër nga Kosova në Turqi. Vitin e kaluar artistët kanë marrë pejsë në festivalin në Çanakkala të Turqisë.

Me Ministrinë e financave diskutohet rimbursimi i energjisë elektrike për personat e verbër

23 nëntor 2023

Një takim i përbashkët me drejtorin e ri të Departamentit të pensioneve z. Blerim Hasani dhe bashkëpunëtorin tonë shumëvjeçarë z. Skënder Asllani.

Në takim u diskutuan shumë tema, e ndër to ishte edhe mundësia për rimbursim për energji elektrike për personat e verbër bazuar në të drejtën ligjore dhe punimi i librezave të verbërisë për vitin 2024 e tutje.

Për çështjen e rimbursimit të energjisë elektrike për personat e verbër, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ka ofruar një platformë për aplikim, mirëpo ka qenë shumë konfuze aplikimi pasi që nuk është rregulluar mirë mënyra e aplikimit për personat e verbër apo edhe të kategorive të personave të tjerë, mirëpo përveç kësaj ka qenë edhe e vështirë aplikimit për disa të qytetar të zonave më të thella. Dhe në këtë kontekst na është kërkuar një listë e atyre personave të verbër të cilët nuk kanë aplikuar në platformë në mënyrë që ky departament ta shqyrtojë mundësinë e rimbursimit të energjisë elektrike e drejtë e garantuar me ligj.

Ndërsa, librezat e verbërisë për anëtarësinë që gëzon një nga dy kategoritë e verbërisë që i njih ligji në Kosovë do të jenë të gatshme dhe, sipas drejtorit të departamentit, ato do fillojnë të shpërndahen nga 1 janari i viti 2024.

Konferenca kushtuar ditës ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

30 nëntor 2023

Në konferencën kushtuar ditës ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila u mbajt në prezencën e zyrtarëve të lartë institucional paraqitëm kërkesën bazë të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, që është zbatueshmëria e ligjit për personave te verbër.

Gjithashtu, theksuam vështirësitë të cilat i kanë hasur personat e verbër në aplikimin e platformës për subvencionimin e benefiteve të energjisë elektrike, ndërsa falënderuam MASHTI-n për përpjekjet për nismat konkrete për krijimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe dhe fillimin për here të parë të zbatueshmërinë se neni 10 pika 3 e ligjit për personat e verbër.

Zyrtarët institucionalë kanë premtuar dhe kanë shpreh gatishmëri për zbatueshmërinë ligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Save the children, partner i rëndësishëm i shoqatës së të verbërve

1 dhjetor 2023

Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka pasur një mbështetje nga Save the Children në vitin 2021-2022, për ofrimin e shërbimeve sociale për personat e verbër. Dhe në një ngjarje organizuar nga ky partner bashkë me 47 ofrues të shërbimeve sociale dhe partnerë kyç, Save the Children Kosova festoi momente të rëndësishme të projektit 'Fuqizimi i Ofrimit të Shërbimeve Sociale për Grupet më të Cenueshme në Kosovë, në Përgjigje ndaj COVID-19' të financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, ku SHVK ishte pjesëmarrës i këtij eventi.

Bashkëpunimi me KFOR-in italian

1 dhjetor 2023

Në zyrat e SHVK së pritem në takim kontingjentin e KFOR-IT italian në Kosovë LMT K8, i përfaqësuar nga GRD.A Cacioppo Lucio me bashkëpunëtorë Lulianella Mauro, Andrea Zizzari, Giovanni Veccnarini dhe Luan Bogaj.

Në takim kryetari z. Daut Tishuki, njoftoj përfaqësuesit e KFOR- it Italian për sfidat që ka shoqata, por gjithsesi edhe për rezultatet e saj falë punës dhe bashkëpunimit me të gjithë akteret e ndryshëm të shoqatës.

Gjithashtu, u diskutua edhe për mundësit e bashkëpunimit në mes të KFOR-it Italian në Kosovës dhe Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

Iniciativa për themelimin e qendrës për studentët me nevoja të veçanta në UP

5 dhjetor 2023

Universiteti i Prishtinës ka ndërmarrë iniciativën për themelimin e qendrës për studentët me nevoja të veçanta.

Qëllimi i qendrës është të ofrojë shërbime mbështetëse të përshtatura për studentët me nevoja të veçanta për të lehtësuar përvojën universitare dhe për të nxitur një përvojë arsimore gjithëpërfshirëse.

Në një takim të përbashkët në objektin e rektoratit, rektori z. Qerimi, prorektorja prof. Llulaku, zëvendëskryeministri i parë z. Beslim Bislimin, z. Nuno Queiros, përfaqësues i përhershëm i UNDP në Kosovë, Forumin Kosovar për Aftësinë e Kufizuar, si dhe profesorë dhe studentë, u theksua rëndësia e krijimit të qendrës dhe ofrimin e shanseve të barabarta për të gjithë.

Kjo nismë qëndron si një dëshmi e përkushtimit të rektoratit ndaj gjithë përfshirjes, diversitetit dhe ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë studentët. Krijimi i kësaj qendre simbolizon përkushtimin e rektoratit për të krijuar një mjedis ku çdo individ, pavarësisht aftësive apo sfidave të tij apo saj, të ketë gjasë të barabartë në arsim cilësor dhe mundësi për rritje dhe sukses personal.

Qendra do përfshijë infrastrukturën dhe pajisjet e nevojshme për studentët si dhe në kuadër të qendrës do jenë pikë kontakti zyrtare për shërbime të studentëve nga çdo njësi akademike të cilët kanë kaluar në trajnimin adekuat.

Kjo iniciativë mbështetet nga UNDP në Kosovë, të cilët i falënderojmë së bashku me gjithë partnerët vendor për mbështetjen.

Nënkryetarja e SHVK merr çmimin "Hyjnesha e shtetit"

8 dhjetor 2023

Në Swiss Diamond u mbajt ceremonia festive për nder të 10 dhjetorit Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, organizuar nga Ambasadorja e Vullnetit të Mirë në Kosovës znj. Elvana Shala. Në këtë ngjarje ishim të ftuar si SHVK por edhe kishim të nominuar anëtares tonë për marrjen e çmimit "Hyjneshat e shtetit".

Felona Bajrami e nominuar nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës, është nderuar me titullin "Hyjnesha e Shtetit" për angazhim dhe përkushtimin e saj për komunitetin e të verbërve.

Të nderuara me titullin "Hyjnesha e Shtetit" në një ceremoni solemne janë nderuar 33 gra e vajza, që kanë dhënë kontribut në përmirësimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

Çmimi ju nda nga Ambasadorja e Vullnetit të mirë znj. Elvana Shala.

Donacion nga kompania Webhelp

20 dhjetor 2023

Kompania Webhelp ka ndarë për SHVK-në 3000€ donacion për aktivitet e saj.

Te pranishëm në zyret e SHVK-se për dhurimin e këtij donacioni ishin Michael Kaindl dhe Edon Guraziu.

Shoqata e të Verbërve të Kosovës për nder të Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop te Bardhë ka nda mirënjohje për këtë kompani e cili tashmë e ka bërë tradicionale donacionin ku në këtë vite është dyfishua shuma e donacionit

SHVK falënderon për këtë kontribute kompaninë Webhelp

Hartimi i strategjisë dhe planifikimi për periudhën pesë vjeçare

Shoqata e të Verbërve të Kosovës gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesëmarrëse dhe aktër aktiv në hartimin e dy dokumenteve të rëndësishme në planifikimin pesë vjeçar. Gjatë muajit dhjetor planifikimin strategjik janë duke bërë Forumi kosovar i aftësisë së kufizuar, ku shoqata është anëtare aktive dhe Qeveria e Kosovës, në të cilin dokument Shoqata e të verbërve të Kosovës ka synimet e saj për të përfshirë objektivat e veta dhe komunitetit që ajo përfaqëson.

Për hartimin e planit strategjik të Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, në datat 15-17 dhjetor në Gjilan është mbajtur punëtorja me organizatat e aftësisë së kufizuar të cilat janë anëtare të Forumit, me ekspertin e jashtëm të angazhuar në këtë proces. Në këtë angazhim SHVK ka dhënë propozimet dhe idetë e veta lidhur me planin e hartuar dhe kornizën strategjike të dokumentit që tashmë ka marrë formën e draftit të parë. Strategjia e re mbulon periudhën 2024-2028 dhe për momentin ka tre objektiva strategjike themelore:

Objektiva strategjike e parë: Fuqizimi i rolit të FKAK si partner i pashmangshëm me institucionet për vendimmarrjen lidhur me të drejtat e PAK.

Objektiva strategjike e dytë: Ngritja e kapaciteteve dhe zgjerimi i organizatës, krijimi i qëndrueshmërisë financiare për të garantuar funksionimin e FKAK në periudhën pesë vjeçare.

Objektiva strategjike e tretë: Partneriteti dhe rrjetëzimi në organizatat ndërkombëtare.

Dokumenti pritet të aprovohet në fillim të vitit 2024 dhe do të jetë ndihmesë në planifikim për periudhën pesë vjeçare në vazhdim, për të cilën periudhë Forumi dhe SHVK kanë planifikimet e veta dhe objektivat e tyre të caktuara.

Gjatë muajve të fundit nëntor dhe dhjetor, Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe të gjitha organizatat që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe me zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës ka marrë pjesë në draftimin e Planit Strategjik të Aftësisë së Kufizuar dhe planin e veprimit 2024-2026. Në këtë draftim janë paraqitur disa objektiva të përbashkëta saktësisht 7 objektiva dhe njëra nga objektivat që është shtuar dhe që është e rëndësishme është edhe ngritja e kapaciteteve nga ana e institucioneve, të OJQ-ve për qëndrueshmëri për të qenë më fleksibili në angazhimin e tyre.

Deri tani janë mbajtur disa takime dhe janë diskutuar objektivat strategjike dhe pikat e veçanta sipas fushave përkatëse, përkatësisht çështjet e shëndetësisë, arsimit, punësimit, kulturës, etj. secila si pikë në vete me ekspertët e fushës.

Duke u bazuar në arritjet pozitive dhe mangësitë e identifikuar të strategjisë 2013-2023, qëllimi kryesor i strategjisë 2024-2029 është të sigurojë që të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara të integrohen pa probleme në të gjitha aspektet e qeverisjes, politikave dhe shërbimeve të Kosovës.

Ky synim i vetëm strategjik në dokumentin e ri të Qeverisë do të ndiqet përmes objektivave specifike të ndërthurura në vijim:

1. Të krijohet kornizë gjithëpërfshirëse e politikave të bazuar në të drejta që integron personat me aftësi të kufizuara në politikat përkatëse dhe planet sektoriale.
2. Të përmirësohen mekanizmat ndër-sektorial dhe koordinues.
3. Të krijohet kornizë e fuqishme monitorimi dhe vlerësimi për të gjurmuar progresin dhe për të vlerësuar ndikimin e nismave të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.
4. Të rritet angazhimi dhe pranimi i një game të gjerë të palëve të interesit, duke përfshirë organizatat e personave me aftësi të kufizuara, agjencitë qeveritare, autoritetet lokale, shoqërinë civile dhe sektorin privat
5. Të forcohet përkrahja dhe përfaqësimi nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara duke rritur të kuptuarit e palëve të tjera të interesit për çështjet e personave me aftësi të kufizuara përmes nismave për ngritjen e kapaciteteve.
6. Të krijohet sistemi për grumbullimin dhe kërkimin e të dhënave për personat me aftësi të kufizuara për të informuar vendimmarrjen e bazuar në prova dhe formulimin e politikave. Të dhënat e besueshme për treguesit që lidhen me personat me aftësi të kufizuara të shërbejnë si bazë për zhvillimin e politikave të informuara.
7. Të promovohet kuptueshmëri më e madhe të çështjeve të personave me aftësi të kufizuara dhe të nxitet ambient gjithëpërfshirës dhe mbështetës duke zhvilluar fushata ndërgjegjësimi dhe programe sensibilizimi. Kjo përpjekje do ta mbështesë shoqërinë gjithëpërfshirëse që përfaqon llojllojshmërinë e anëtarëve të vet.

Sa i përket planifikimit strategjik të vetë Shoqatës së të verbërve të Kosovës, SHVK ka një plan strategjik që mbulon edhe vitin 2024. Ndërsa gjatë viti në vazhdim dhe Shoqata e të verbërve planifikon hartimin e strategjisë 2025-2029, që do mbulojë periudhën pesë vjeçare në vijim.

Viti kushtuar personave me aftësi të kufizuara, arritjet dhe ngecjet në fushën e shëndetësisë dhe arsimit

Për të përkrahur Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, në Dhjetor të vitit 2021, Qeveria e Kosovës kishte shpallur vitin 2022 si vit të personave me Aftësi të Kufizuara. Kjo po ndodhte për herë të parë në Kosovë dhe ishte parë si një mundësi e mirë për të ngritur vetëdijen edhe të publikut edhe të institucionet në Kosovë mbi gjendjen dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Për këtë arsye pritjet dhe shpresat kanë qenë të mëdha, pasi mekanizimi zbatues i këtij vendimi kishte parasysh gjithë aparatit shtetëror.

"Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022" është dokumenti që u hartua në bashkëpunimin e Qeverisë me ministrinë përkatëse dhe me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (HandiKOS; Shoqata Kosovare e të Shurdhërve; Shoqata Kosovare e të Verbërve; Syndrome Down Kosova; Autizmi; dhe Forumi i Kosovës për Aftësinë e Kufizuar) dhe ky kalendar u

organizuar shtatë punëtori njëditore në të cilat aketrët punuan së bashku në identifikimin dhe planifikimin e aktiviteteve të Kalendarit të aktiviteteve për vitin 2022".

Me përmbylljen e vitit kushtuar personave me aftësi të kufizuara, në muajt në vazhdim me raportet nga secila ministri dhe me komente nga shoqëria civile, raporti përfundimtar vë në pah arritjen për secilin nga shtatë komponentët e planit të bazuar në rezultatet të cilat synohet të arrihen: Shëndetësia, Edukimi & Arsimimi, Punësimi, Qasja, Mirëqenia Sociale, Kultura & Sporti dhe Drejtësia & Siguria. Në këtë artikull po paraqesim arritjet dhe ngecjet për katër komponentët e para përkatësisht shëndetësia, arsimi, punësimi dhe qasja, në mënyrë që të kemi parasysh nivelin e angazhimit të qeverisë dhe se sa janë të adresuara këto çështje në institucionet kosovare.

Komponenti 1 – Shëndetësia

Aktivitetet e realizuara brenda secilës komponentë janë si në vijim:

Për zbatimin dhe monitorimin të "Kalendarit të Aktiviteteve për vitin 2022 'Vit i personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës", ministria ka formuar Grupi Punues, që është marrë me këto aktivitete.

Në fushën e legjislacionit lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për shërbimet cilësore shëndetësore Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka propozuar Qeverisë së Kosovës të aprovoj aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë për llojet e pajisjeve ndihmëse falas për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, që shërbejnë për lëvizje, parandalim dhe asistim, i cili bazohet në Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik në Kosovë. Qeveria e Kosovës në muajin në 2022 e ka aprovuar atë me emrin Udhëzimi Administrativ për caktimin e Listës, Llojeve dhe Pajisjeve Ndhimesë që ofrohen falas për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, që shërbejnë për Lëvizje, Parandalim dhe Asistim.

Ministria e Shëndetësisë në bashkëveprim me SHSKUK ka pasur të nxjerrin vendimin për themelimin e njësisë spinale për personat me lëndime spinale në kuadër të SHSKUK në Prishtinë. Për këtë çështje është dërguar kërkesa për përgjegjës plotësim-ndryshimin e statutit të QKUK-së dhe në momentin e raportimit ka qenë në proces, por e pa përfunduar.

Qeverisë së Kosovës poashtu ka aprovuar vendimi për iniciimin e procesit të amendamentin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjegjësisht Nenit 22 për përfshirjen e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Lidhur me Aktivitetin 1 “përditësimi i listës së barnave esenciale me nevojat e propozuara nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK), në listë nga ministria është dërguar tek Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) pasi kërkesa ka qenë që anëtarë të grupit punues për përditësim të listës esenciale të barnave të jetë një përfaqësues i OPAK.

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 102-të ka aprovuar kërkesën e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 4200100 eurove me qëllim të blerjes së barnave nga lista esenciale. Ministria e konsideron se është zbatuar ky aktivitetet.

Aktiviteti 2 ka qenë që në hyrje (recepzione) të institucioneve shëndetësore (QKMF dhe QKUK të vendosen monitor të cilët ofrojnë informata në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër si dhe sigurohet një numër telefoni kujdestarë i cili përmes “telefonave tabletë” ofron “online” shërbimet e interpretimit në gjuhën e shenjave në rastet kur personat e shurdhër i drejtohen institucioneve shëndetësore.

MSh ka dërguar këtë kërkesë në të gjitha QKMF-të në nivel të Republikës së Kosovës për të ofruar të dhënat nëse ekzistojnë monitorë të tillë në hyrje (recepzione) të institucioneve shëndetësore por në MSh nuk janë kthyer përgjigjet nëse këto të dhëna janë siguruar.

Lidhur me më këtë aktivitet organizata AQH-se (Accessible Quality Healthcare) ka shprehur gatishmërinë që të pajisë QKMF-të në Komunitatet e Kosovës me monitor, ekrane në të cilat do paraqiten informatat në gjuhën e shenjave. Ata kanë dhuruar 20 monitorë në 6 regjione të Kosovës e poashtu janë përcjell materialet e nevojshme në 20 komuna si video, material në gjuhën e shenjave si dhe me titra si dhe janë shoqëruar edhe me zë në mënyrë që të jenë të qasshme edhe për personat e verbër po ashtu.

Videot që emitohen aty janë ato për faktorët e rrezikut për sëmundjet jo-ngjitëse, video për aktivitetin fizik, video për duhanpirjen pasive, për të ushqyerit, video për reduktimin e sheqerit dhe kripës, postera të ndryshëm për 4 Faktorët kryesore të sëmundjet jo-ngjitëse. Pastaj ka video me emsazhe për diabetin, hipertensionin, Covid 19, vaksinat sezonale dhe për të drejtat e pacientëve. Aktiviteti konsiderohet i zbatuar.

Kurse pjesa tjetër e aktivitetit 2 për telefonat kujdestarë me tableta që ofron shërbimet e interpretimit në gjuhën e shenjave nuk është zbatuar.

Nuk është zbatuar as aktiviteti i tretë sipas të cilit Repartet e Neonatologji/Gjinekologjisë në QKUK dhe të gjitha Spitalet Regjionale do të pajisen me aparate të cilat mundësojnë identifikimin e hershëm të

pengesave në dëgjim / humbjen e dëgjimit. Këto aparate do mundësonin ekzaminimet te foshnjat përmes aplikimit të metodave EOA (emetimet otoakustike) dhe RAATT (reagimi i automatizuar auditiv i tringut të trurit). MSH fillimisht ka mbledhur të dhëna dhe ka konstatuar se në të gjitha spitalet regjionale nevojiten 11 aparate të tilla, e më pas MSh nuk ka raportuar nëse ka arritur ndonjë progres.

Aktiviteti i katërt i këtij kalendari ka qenë që repartet e gjinekologjisë në QKUK dhe spitalet regjionale pajisen me shtretër hidraulik për ekzaminime gjinekologjike dhe obstetrike të femrave me aftësi të kufizuara dhe ai nuk është zbatuar. MSh bashkë me përfaqësuesit e SHSKUK-së ka identifikuar se për plotësimin e këtij aktiviteti në QKUK dhe në spitalet regjionale nevojiten nevojiten 20 shtretër hidraulik dhe pas kësaj nuk është ndërmarrë asgjë për plotësimin e kësaj pike.

Aktiviteti i pestë dhe u fundit në fushën e shëndetësisë ka qenë krijimi i një grupi punues, i përbërë nga ministrinë e linjës (përkatësisht MSH, MASHTI dhe MFPT), përfaqësues të shoqatave të PAK-ve si dhe grupe të tjera të interesit për të krijuar formulën e cila do të mundësonte financimin dhe shtrirjen e shërbimeve të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara. Aktiviteti është zbatuar pjesërisht nga MSH, pasi që ky aktivitet është planifikuar edhe në “Ligjin Gjithëpërfshirës” dhe i njëjti është në procesin final të hartimit të tij, aktualisht nuk është iniciuar ndonjë veprim lidhur me këtë aktivitet. Por përfaqësuesit e OPAK kanë thënë se ky aktivitet nuk përfshihet në “Ligjin Gjithëpërfshirës” prandaj u kërkua veprim në këtë drejtim nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Për implementim të këtij aktiviteti, në muajin qershor dhe korrik 2022 Ministria e Shëndetësisë ka formuar grupin punues për të krijuar formulën e cila do të mundësonte financimin dhe shtrirjen e shërbimeve të vazhdueshme për Personat me Aftësi të Kufizuara, i cili ka mbajtur disa takime deri në periudhën e raportimit.

Komponenti 2 – Edukimi & Arsimi

Fusha e edukimit dhe arsimit ka qenë një fushë në të cilin ka pasur ndër më së shumti aktivitete të planifikuara gjatë vit kushtuar personave me aftësi të kufizuara. Me 13 aktivitete të planifikuara, pjesa më e madhe e të cilave është zbatuar apo është në proces.

Aktiviteti i parë ka qenë që ora e parë e mësimin me datën 3 dhjetor për nxënësit në arsimin fillor dhe të mesëm të informohen mbi aftësinë e kufizuar dhe situatën e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. MASHTI e ka kryer këtë me sukses duke përgatitur materiale dhe udhëzues për mësimdhënësit

Aktiviteti i dytë është në proces dhe janë identifikuar 10 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe 5 shkolla të mesme të larta që nuk kanë qasje fizike për fëmijët/nxënësit me aftësi të kufizuara dhe aty është në proces ndërtimi i pjerrinave për qasje. Bëhet fjalë për shkollat janë: Prishtine Sh.M.L. “Ahmet Gashi”, Podujeve Sh.F.M.U. “Shaban Shala”, Mitrovicë Sh.F.M.U. “Abdullah Shabani”, Skenderaj/Tushile, Sh.F.M.U. “Ganimete Tërbeshi”, Ferizaj Sh.F.M.U. Ganimete Tërbeshi”, Lipjan Sh.F.M.U. “Vëllezërit Frashëri”, Gjiilan Sh.M.L. “Esat Berisha”, Novobërda Sh.F.M.U. “Asdreni”, Kamenice/ Karaqeve e Epërme Sh.F.M.U. “Avni Rrustemi”, Prizren Sh.F.M.U. “Fadil Hisari”, Klinë Sh.M.L. “Luigj Gurakuqi”, Malishevë Sh.M.L. “Lasgush Poradeci”, Dragash/ Bloç Sh.F.M.U. Ilmi Baftjari”, Pejë Sh.F.M.U. “Xhemail Kada, dhe Gjakovë Sh.M.L. “Hajdar Dushi”.

Aktiviteti i tretë për punësimin e dy mësimdhënësve për shkrimin e Brailit dhe Orientimit & Mobilitetit në Qendrën Burimore "Xheladin Deda" dhe përmes këtij angazhimi të mbështetën fëmijët e verbër dhe gjysmë të verbër në gjithë Kosovën nuk është realizuar. MASHTI ka thënë se për zbatimin e këtij aktiviteti kanë hasur në sfida buxhetore për të punësuar dy persona.

Aktiviteti i katërt që ka qenë një synim ambicion për krijimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe, duke mundësuar kështu që personat e verbër të mund të shfrytëzojnë tekstet digjitale sipas nenit 11 të Ligjit për të Verbër. MASHTI ka hartuar kriteret bazë të sintezës vokale pastaj u nda buxheti në shumën prej 1.1 milion euro, janë hartuar termat e referencës për tender ndërkombëtar për sigurimin e sintezës vokale në gjuhën Shqipe, dhe pas shpalljes së tenderit është përzgjedhur një kompani dhe është në proces të zbatimit.

Aktiviteti i pestë që është akreditimi i programit për shkrim në Brail dhe ofrimi i trajnime për mësimdhënës, është iniciuar por nuk është zbatuar ende.

Aktiviteti i gjashtë Rritja e numrit të asistentëve të punësuar në shkolla 100 asistentë të punësuar është arritur pasi deri në periudhën e raportimit në fund të vitit janë punësuar mbi 80, ndërsa gjatë vitit 2023 janë punësuar edhe disa të tjerë. Gjatë vitit 2022 janë punësuar asistentët sipas komunave: në Prishtinë 15, Prizren 4, Gjilan 4, Gjakovë 5, Mitrovicë 4, Pejë 6, Ferizaj 3, Podujevë 5, Kamenicë 5, Kaçanik 5, Deçan 3, Klinë 1, Istog 3, Suharekë 3, Vushtrri 2 Drenas 3, Skenderaj 3, Lipjan 3, Dragash 1, Hani i Elezit 2, Obiliq 3, Fushë Kosovë 6, Viti 2, Novobërdë 1, Shtime 1, Malishevë 3, Junik 1, Rahovec 1. Kurse punësimi i tre asistentëve të gjuhës së shenjave në Qendrën Burimore "Nëna Terezë" në Prizren, për të mbështetur fëmijët me dëmtime në dëgjim është zbatuar dhe kanë filluar punën tre asistent dhe një interpret i gjuhës së shenjave.

Aktiviteti i shtatë për zhvillimin i planit për ofrim të arsimit joformal në Qendrat Burimore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara thuhet se është iniciuar, por nuk është raportuar më pas për ecurinë.

Aktiviteti i tetë funksionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Ekipeve Vlerësuese Pedagogjike në komuna për specifikat e llojeve të aftësisë së kufizuara, trajnime që janë mbajtur në vazhdimësi nëpër komuna si trajnime dy ditore për përdorimin e KNF-së për Ekipet Vlerësuese Pedagogjike brenda qendrave burimore. Pjesa tjetër e trajnimeve është në proces.

Aktiviteti i nëntë hartimi i instrumenteve për identifikimin dhe vlerësimin e vështirësive në të nxënë nga psikologët në shkolla, ngjashëm është iniciuar si proces, por pastaj MASHTI ka raportuar më pas se nuk është bërë nënshkrimi i një memorandumit mirëkuptimit me Fakultetin të Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për këtë çështje.

Aktiviteti i dhjetë për akreditimin e gjuhës së shenjave si gjuhë e dytë amtare për mësimdhënësit që punojnë me nxënësit me dëmtime në dëgjim, prindërit dhe të tjerë që janë të interesuar të mësojnë gjuhën e shenjave, është adresuar dhe është në proces.

Aktiviteti i njëmbëdhjetë që poashtu ka të bëjë me akreditimin e kualifikimit (niveli i 5-të) Interpret i Gjuhës së Shenjave, me ç' rast MASHTI do të hartojë programin për këtë kualifikim që përfshin:

standardin e profesionit, kurrikula për lëndët, materialet mësimore dhe planin e realizimit. Edhe kjo është poashtu në proces.

Aktiviteti i dymbëdhjetë i kalendarit: Trajnimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve të shkollave të arsimit të mesëm të lartë për qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara është mbajtur me 70 profesionistë arsimor (drejtorë, mësimdhënës, pedagogë/psikologë) nga 7 shkolla pilote, shkolla të mesme të larta që janë trajnuar për arsim gjithëpërfshirës nga projekti INCLUDE.

Dhe aktiviteti i fundit, trembëdhjetë po ashtu është batuar. Është bërë trajnimi i mësimdhënësve të 25 shkollave për qasjen dhe arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe janë certifikuar mësimdhënësit e 7 shkollave në dy module ndërsa pritet të punohet në vazhdimin e trajnimit të mësimdhënësve të 18 shkollave të tjera fillore dhe të mesme të ulëta. Edhe 33 mësimdhënës nga 6 qendrat burimore janë trajnuar për t'u aftësuar si trajnerë për Modulin 1 të trajnimit Aftësia e Kufizuar dhe Arsimi gjithëpërfshirës ndërsa 37 zyrtarë komunal (për arsim gjithëpërfshirës dhe për komunitete dhe kthim) janë trajnuar për Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave, arsim gjithëpërfshirës dhe për legjislacionin dhe politikën e arsimit gjithëpërfshirës.

Janari në Kosovë pa viza: të drejtat dhe obligimet e udhëtimit për qytetarët e Kosovës

Disa informata lidhur me qarkullimin pa viza në Evropë. Qytetarët e Kosovës duhet të kenë kujdes për të zbatuar mirë detyrimet që kanë dhe poashtu duhet të jenë të informuar se cilat të drejta kanë dhe si mund t'i realizojnë ato. Në vazhdim keni përgjigjen në pyetjet kryesore lidhur me qarkullimin pa viza në vendet e Shengenit në Evropë.

A nënkupton liberalizimi punësim në shtetet e zonës Shengen?

Jo! Liberalizimi i vizave në asnjë rast nuk nënkupton mundësi punësimi në shtetet e zonës Shengen.

A do të më duhet të aplikoj për vizë studentore nëse planifikoj të udhëtoj në zonën Shengen për studime?

Po, ju duhet të aplikoni për një vizë studentore në rast se keni ndërmend të kryeni studime që i kalojnë 90 ditë qëndrimi në zonën Shengen brenda një periudhe prej 180 ditësh. Për studime duhet të aplikoni për një vizë studimore derisa dokumentet e nevojshme dhe rregullat ndryshojnë nga vendi në vend. Prandaj rekomandohet që të konsultoheni me ambasadën ose konsullatën e vendit në të cilin planifikoni të filloni studimet.

Kush nuk mund të udhëtoj në zonën Shengen?

Persona që figurojnë në listat e personave që përbëjnë kërcënim për rendin, shëndetin publik apo sigurinë e brendshme. Persona ndaj të cilëve është dhënë masa ndalim hyrje qoftë edhe në një nga vendet e zonës Shengen, apo kanë qenë subjekt i një urdhër largimi, largimi me forcë (kthimi apo dëbimi), që kryesisht zbatohen për raste të qëndrimit të paligjshëm.

A mund të më refuzohet hyrja në shtetet e zonës Shengen?

Policia kufitare e shtetit Shengen ka të drejtë t'i mohojë hyrjen çdo qytetari në rast se:

Nuk ka pasaportë me vlefshmëri të mjaftueshme (minimumi 3 muaj pas periudhës së planifikuar të kthimit nga zona Shengen);

Paraqet dokumente të falsifikuara;

Nuk posedon dokumente që dëshmojnë qëllimin e udhëtimit;

Nuk paraqet dëshmi se ka mjete të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit;

Ka tejkalluar 90 ditë qëndrimi në periudhën 180 ditore;

Paraqet rrezik për sigurinë publike, shëndetin publik apo marrëdhëniet ndërkombëtare për një apo më shumë shtete të Shengenit;

Kur ka të dhëna se personi është përfshirë në aktivitete kriminale apo dëshmi të qarta se ka për qëllim një gjë të tillë.

A mund të udhëtoj për arsye shëndetësore?

Kur arsyetohet juve ju mundësohet udhëtimi në zonën Shengen për trajtime shëndetësore. Ky udhëtim duhet të jetë brenda periudhës maksimale prej 90 ditëve. Varësisht nga shteti që vizitohet juve mund t'ju kërkohen dokumente të ndryshme si pjesë e verifikimit të kushteve për qëndrimin tuaj. Për shembull, juve mund t'ju kërkohet dëshmi nga institucioni shëndetësor pritës si dëshmi për trajtimin shëndetësor të planifikuar apo ftesa për analizat mjekësore. Gjithnjë të keni kujdes që trajtimi shëndetësor duhet të përfundoj brenda periudhës 90 ditore. Nëse trajtimi do të zgjas më shumë se 90 ditë, atëherë duhet të siguroni vizën përkatëse përmes ambasadës përgjegjëse.

Çfarë pasoja mund të keni në rast të shkeljeve eventuale?

Në rast të shkeljeve eventuale dhe abuzimit të udhëtimit pa vizë, pasojat personale përfshijnë: shqiptimin e gjobës financiare, shënim zyrtar në pasaportën dhe dosjen tuaj ku figuron shkelja në sistemin Shengen si dhe ndalimi i hyrjes së zonën Shengen deri në 5 vite.

Çfarë dokumente duhet të marr me vete?

Pasaportë biometrike (e vlefshme për të paktën tre muaj pas datës së largimit nga zona Shengen); Dëshmi mbi qëllimin e udhëtimit në zonën Shengen; Dëshmi mbi qëndrimin si rezervimi i hotelit apo detajet e vendit ku do të qëndroni; Detajet e udhëtimit, duke përfshirë rezervimin e biletës kthyesë; Nëse udhëtohet me veturë, dokumentacionin e nevojshëm të veturës; Dëshmi se keni mjete të mjaftueshme financiare.

Kur mund të udhëtoj pa vizë? .

1 janar 2024

Sa ditë mund të qëndroj në zonën Shengen?

Udhëtimi pa vizë ju mundëson qëndrime afatshkurta deri në 90 ditë brenda periudhës prej 180 ditësh (çdo gjashtë muaj).

Si llogaritet periudha 90 ditë brenda periudhës prej 180 ditësh?

Periudha 90 ditë fillon që nga momenti kur ju hyni për herë të parë në zonën Shengen. Për shembull, nëse më datë 1 janar 2024 ju hyni për herë të parë në zonën Shengen, periudha e ardhshme gjashtë mujore fillon pas 180 ditësh ose më saktë me 29 qershor 2024. Pra, brenda këtyre 180 ditëve ju mund të qëndroni në zonën Shengen vetëm deri në 90 ditë. Nëse udhëtoni shpesh në zonën Shengen, duhet të numëroni ditët e mbetura nga periudha e fundit gjashtë mujore.

Me rëndësi:

Hyrja pa vizë në Bashkimin Evropian nuk është e garantuar. Hyrja mund të refuzohet nga policia kufitare në rast se nuk keni pasaportë valide me afat të mjaftueshëm, nuk keni dokumente që dëshmojnë qëllimin e udhëtimit dhe dëshmi se keni mjete të mjaftueshme financiare për qëndrimin e planifikuar në zonën Shengen, apo në të kaluarën keni tejkaluar 90 ditë qëndrimi në periudhën 180 ditore.

Për më shumë informata vizitoni <https://integrimievropian.rks-gov.net>

Aktivitetet arsimore dhe edukative në shkollimin e personave të verbër në Kosovë

Qendra burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda” ka zhvilluar aktivitetet e veta dhe në bashkëpunim me partneritet e vet në dy muajt e kaluar ka rritur kapacitet e punës dhe materiale në shkollimin e personave të verbër në Kosovë. Në këto aktivitete është mbajtur bashkëpunimi i mirë me shoqatën e personave të verbër dhe komunitetin, me Mistrinë e Arsimit Shkencës dhe teknologjisë dhe organizatat tjera bashkëpunëtoresh dhe partnerë të përhershëm të qendrës burimore., në vijim janë aktivitetet kryesore të zhvilluara në këtë qendër në dy muajt e fundit të vitit 2023, nëntor dhe dhjetor.

32 libra të ri në braj për bibliotekën e shkollës

22 dhjetor Nga Lions Club Istogu u bë dorëzimi i titujve të lirë të lektyrës shkollore me 32 tituj të ri në shkrimin braj. Librat për nevojat e nxënësve dhe mësimit në klasat e ciklit të ulët dhe shkollës së mesme të ulët plotësojnë nevojat e QB që për kohë të gjatë nuk ka shtuar libra në bibliotekën e shkollës. Projekti është mbështetur financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe sportit

SBASHK mban trajnim për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës

16 dhe 24 dhjetor- Sindikata e Arsimit Para universitar e Pejës dhe nga niveli qendror kanë mbajtur në dy vikende trajnimin “Roli i mësimit për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës”, që u mbajt në ambientet e Qendrës Burimore “Xheladin Deda”. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj i shoqëruar nga kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Pejës Isuf Lajçi, veprimtarja sindikale Lumnije Berisha dhe trajnerja Drita Kamberi janë takuar me drejtorin e këtij institucioni të dalluar arsimor Xhavit Kastrati dhe me kryetarin e shoqatës sindikale Gani Gashi. Kryetari Jasharaj ka falënderuar drejtorin Kastrati dhe mësimit Isuf Ahmetaj për angazhimet në krijimin e kushteve për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. Pas kësaj ata kanë marrë pjesë në nismën e trajnimit, që ka për qëllim të përgatit mësimit për t’u përballur me sfidat e kohës e në përpjekje për të mbrojtur nxënësit nga format e rrezikshme të punës.

Takimi i drejtorëve të qendrave burimore

20 dhjetor Takimi i fundit për këtë vit i drejtorëve të qendrave burimore në Kosovë është organizuar nga Qendra Burimore në Pejë. Takimet e tilla shërbejnë për koordinimin mes qendrave burimore dhe MASHTI-t.

Përrurimi i librave në braille të autorit Betim Bregovina

16 dhjetor - Në njëzet vjetorin e fillimit të krijimtarisë është autori të verbër Betim Bregovina, ish nxënës i shkollës sonë, QBMK ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar në Prishtinë. Është bërë përrurimi i tetë librave në formatin braille dhe akustik. Këta libra kanë qenë në formatin e shkruar dhe janë botuar që nga viti 2004 deri në vitin 2018. QB ka mbështetur Bregovinën kur ishte nxënës duke ndihmuar në publikimin e librave promovimin e tyre dhe të autorit. Betim Bregovina ka shkruar mbi 10 libra deri më tash dhe ka pasur disa ekspozita arti në Kosovë.

Riparimi i bibliotekës së shkollës

Gjatë muajit nëntor në shkollë është bërë aksioni i pastrimit dhe rregullimit të zyrës së bibliotekës së shkollës. Ambienti në të cilën në dekada ruhen dhe mirëmbahen librat në braille kishte kohë që nuk ka pasur riparime dhe hapësira kohë pas kohe kishte pasur dëmtimet e kohës dhe ndikimit të reshjeve atmosferike. Për këtë arsye stafi i shkollës ka filluar aksionin vullnetar të pastrimit dhe risistemimit të bibliotekës. Në ditët e pushimit vjeshtor është bërë pastrimi i ambientit, përzgjedhja dhe selektimi i librave të nevojshëm, duke zëvendësuar librat e vjetra që kanë dalë afatit dhe funksionit të vet. Për këtë është dashur të hiqen një sasi e madhe librash, nga të cilat shkolla ka mbajtur vetëm ndodhje kopje për arkivim, ndërsa të tjerat janë asgjësuar, duke përfshirë edhe mjaft libra të dalë nga përdorimi, të dëmtuar nga kushtet e mirëmbajtjes dhe me kalimin e kohës. Nga një kopje të rreth 100 titujve në 150 kopje libri i janë dorëzuar bibliotekës së qytetit të Pejës “Azem Shkreli”, që ka krijuar këndin e leximit në braj, ndërsa fondet janë plotësuar me fondet e librave në audio dhe librat e ri të dhuruar nga Lions Club Istogu.

Njëkohësisht është bërë edhe krijimi i arkivit të shkollës, një ambient i përshtatshëm që krijohet për herë të parë për ruajtjen e dokumentacionit, librave amë dhe ditarëve.

Me aktorët Teatri Istref Begolli për një javë më ndryshe

06 dhjetor- Në kuadër të programit ndërministror “Arti në Shkollë”, drejtoresha e Teatrit Profesional “Istref Begolli”, znj. Krenare Luta Radoniqi së bashku me aktorët e trupës rezidente Fitore Broqi, Luan Daci dhe Shpresa Salihaj realizuan aktivitetin e parë “Artisti në klasë” duke i njoftuar nxënësit rreth historikut dhe veprimtarisë së punës së Teatrit.

Nxënësit e QBMK "Xheladin Deda" me bashkëmoshatarët e tyre nga SHFMU “Dardania” Pejë dhe SHFMU “Hil Mosi” Jabllanicë e Vogël, përmes bashkëbisedimit dhe lojës së zhvilluar me aktorët përfituan njohuri për ecurinë e punës nga fillimi deri në finalizimin e një shfaqje teatrale. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini Dhe Sport të Komunës së Pejës

Kosova triumfon në turneun ndërkombëtar të futbollit për të verbër

4 dhjetor – Kampionati Nacional i FFK-së në Hajvali u bë pritës i një ngjarje të rëndësishme sportive – turneut ndërkombëtar të futbollit për të verbër. Ky turne u organizua në bashkëpunim të ngushtë mes FFK-Së, UEFA-s dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Sportit për të Verbrit (IBSA), me përfshirjen e tri ekipeve: Kosovës, Austrisë dhe Sllovenisë.

Ekipi i Kosovës në të cilin ka në përbërje nxënës dhe ish nxënës e staf nga shkolla jonë doli fitues i këtij turneu pas përballjeve interesante. Ky turne ndërkombëtar shërben si një shembull i përpjekjeve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për të fuqizuar rolin e sportit edhe në komunitetin e të verbërve dhe gjithashtu nxiti ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e përfshirjes dhe mundësive të barabarta në futboll për të gjithë.

Fëmijët ndërtojnë qytetin e mundësive

1 dhjetor - Në Ditën ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara në qendër të Pejës nxënësit kanë marrë pjesë në aktivitetin "Ndërtojmë një qytet gjithpërfshirës me LEGO", i quajtur Qyteti i Mundësive. Aktiviteti është organizuar nga Qendra e Kujdesit Ditor- “Pema” në Pejë.

Rregullimi dhe përtëritja e parkut dhe gjelbërimit

30 nëntor - Bashkë me Komunën e Pejës është bërë angazhimi i përbashkët për një ambient më të sigurt. Aksion i pastrimit dhe rregullimit të pemëve në oborrin e shkollës ka qenë një nevojë e kohës dhe përveçse ka zbukuruar pjesën prapa shkollës, ka shmangur edhe rreziqet e mundshme që mund të kishte pasur nga rritja dhe zgjerimi i madh i pemëve të mbjella dekada më parë.

Vizitë Filarmonisë së Kosovës

16 nëntor- Nxënësit e QBMK "Xheladin Deda" kanë bërë një vizitë njëditore në Prishtinë ku kanë qenë mysafirë në Filarmoninë e Kosovës. Aktiviteti zhvillohet në kuadër të aktivitetit "Arti në shkolla" dhe nxënësit e kanë pasur mundësitë edhe të takojnë edhe të dëgjojnë interpretime nga instrumentistët e filarmonisë kosovare.

Zhvillimi i aktiviteteve sportive me personat e verbër në Kosovë

Zhvilluar në periudhën tetor-dhjetor 2023

Vrapimi për shëndetin

Me datën 1 tetor Komiteti Paralimpik I Kosovës me ftesë të zonjës së parë të Kryeqytetit, znj. Kristale Rama, mori pjesë si pjesë e nismës "Vrapo për Shëndetin". Në këtë aktivitet morën pjesë parasportistët me dëmtime të ndryshme dhe u mirëpritën nga gjithë publiku I gjerë.

Filloi kampionati i golballit

Filloi kampionati i Golballit-sezoni vjeshtor përkatësisht më datën 7 tetor. Kampionati do të zhvillohet në dy grupe: Grupi A dhe B. Përballja e parë në mes të ekipeve të grupit A u mbajt në palestrën "Hakif Zejnullah" në Podujevë ndërsa grupi B më datën 8 tetor zhvilloi ndeshjet e para në Palestrën e Sporteve të Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë. Pjesëmarrës nga të dy grupet ishin 8 ekipe ku presim rezultate dhe avancim të sportistëve nga këto gara.

Kampionati Botëror i Shahut për të Verbrit në Greqi

Kampionati Botëror Individual i Shahut IBCA 2023 për të verbrit dhe me shikim të dëmtuar është zhvilluar në ishullin Rodos, Greqi, nga data 08-18 tetor. Veprimtaria e organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Shahut Braille (IBCA), Federata Greke e Sporteve për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Klubi i Shahut "Ippotis", mbledhë së bashku 80 lojtarë nga 31 vende. Gara zhvillohet në kuadër të Festivalit Botëror të Shahut në Rodos. Turneu do të mbahet sipas rregullave zyrtare të IBCA dhe FIDE si një ngjarje me nëntë raunde, e sistemit zviceran, me një raund të luajtur çdo ditë. Të verbrit përdorin tabela braille për të luajtur shah. Një tabelë e tillë shahu ka modifikime të veçanta që ndihmojnë lojtarët me shikim të dëmtuar. Të gjithë katrorët e zinj janë ngritur disa milimetra për t'u identifikuar lehtësisht me prekje, dhe secili prej katrorëve ka një vrimë në qendër në të cilën pjesë janë të fiksuara fort me ndihmën e gozhdëve në bazat e tyre. Më 8 tetor në Rhodes-Greqi. Favoriti i vlerësimit të turneut është GM Marcin Tazbir (2494, Poloni), fituesi i Kampionatit Botëror FIDE për Personat me Aftësi të Kufizuara 2023. "Kur njerëzit luajnë me mua, ata nuk mendojnë për paaftësinë time, ata mund të mos e vënë re atë. Por ndonjëherë, të luash me personat me aftësi të kufizuara mund të jetë e vështirë për njerëzit e shëndetshëm për shkak të faktit psikologjik që po luan kundër një personi me aftësi të kufizuara. Edhe pse ju ende dëshironi të fitoni, ndonjëherë ndiheni paksa fajtor për veten tuaj që po luani një lojë të tillë. Turnetë ku personat me aftësi të kufizuara mund të takohen së bashku dhe të konkurrojnë janë diçka e veçantë. Për të gjithë ne, është një mundësi e shkëlqyer për të kapërcyer kufijtë tanë." thotë Tazbiri.

Aktivite e Javës së njeriut me shkop të bardhë

Për nder të "Javës së njeriut me shkop të bardhë" Federata e sporteve për të verbër e Kosovës, organizoi turnir shahu për të verbër, ku pjesëmarrës ishin diku rreth 13 shahistë të cilët janë edhe përfaqësues të Kosovës në gara ndërkombëtare në fushën e shahut. Aktiviteti u realizua me përkrahjen e Ministrisë së

Kulturës, rinisë dhe sportit i cili është mbajtur në Shëngjin të Shqipërisë nga data 20.10.2023 deri më datë 22.10.2023.

Mbahen garat e ligës së golballit

Vazhdon liga e golballit me një performancë të shkëlqyer nga sportistët. Sportistët u angazhuan në xhiron e radhës u mbajt në qytetin e Gjilanit dhe Skenderajit ku do të ju mbajmë të informuar për rezultatet në vazhdim.

Turniri ndërkombëtar golballit në Selanik

U mbajt Turniri ndërkombëtar në Selanik të Greqisë i cili titullohet “Selaniku 2023” ku edhe Kosova ishte pjesëmarrëse në këto gara ku arriti të shënojë edhe fitore përkrah superfuqive evropiane në goalball. Lojtarët të cilët e përfaqësuan Kosovën në këtë turnir ishin: Shqipron Kuliqi ,Daut Hoxha, Rinor Ymeri, Bekim Krasniqi, Mark Pjetraj.

Turni ri ndërkombëtar i futbollit në Kosovë

Me datën 3 dhjetor 2023 u mbajt Turniri ndërkombëtar i Futbollit për të verbër. Ku të pranishëm ishin: Kosova, Sllovenia, Austria. Kosova shënoi fitoren kundër Sllovenisë me rezultat 3-0 ku golashënuesit ishin Mark Pjetraj, Shqipron Kuliqi. Goli i parë u shënuar nga kapiteni, Mark Pjetraj, kurse dy golat e tjerë u realizuan nga Shqipron Kuliqi. Vërejmë se kombëtarja e Kosovës po zhvillohet çdo ditë e me shumë.

Portret sporti Shqipron Kuliqi

Një sportist dhe aktivist i shkëlqyer

Shqipron Kuliqi nga komuna e Skenderajt prej disa vitesh është një sportist shumë i dalluar në radhët sportistëve të angazhuar në sportet për personat e verbër në Kosovë. Një nxënës dhe student i shkëlqyeshëm në të kaluarën, Shqipëroni ka përfunduar studimet për gazetari në Universitetin e Prishtinës dhe ka punuar një kohë edhe në gazetari sportive.

Nga ana tjetër, që në moshë të re ai është angazhuar në sporte për të verbër: gollboll për një kohë të gjatë i angazhuar me sukses si një nga sportistët më të mirë dhe shutuesit më të mirë. Tash është angazhuar dhe ka rritur suksese edhe në fushën e futbollit për të verbër, një sport që ka zënë filllet e tij vitin e kaluar në Kosovë.

Në vazhdim është një rezyme e sukseseve të arritura këtë vit. Ka qenë një postim nga vetë Shqiproni në rrjetet sociale që ka bërë një analizë të vit që shkoi.

Më 12 shkurt - në Malmo të Suedisë në turneun "Malmo Open 2023" në Goalball, Kosova u rendit në vendin e dytë, ku morëm medaljen e argjendtë dhe fitova çmimin e golashënuesit më të mirë të turneut me 55 gola të shënuar.

Më 10 mars - mora iniciativën dhe themelua Klubin e Goalballit "Drenica", ku do ta bëjmë krenar tërë qytetin e Skenderajt me sukseset tona.

Më 29 prill - Kombëtarja e Kosovës në Futboll për të Verbër mori pjesë në Austri, ku morëm barazimin e parë historik dhe pikën e parë të fituar në lojë.

Më 30 maj - përfundova një projekt 3-vjeçar, duke i postuar xhamitë e trojeve shqiptare, ku postova 1143 xhami të ndryshme.

Më 17 shtator - Klubi i Goalballit "Drenica" fitoj vendin e dytë dhe medaljen e argjendtë në "Lojërat Parasportive 2023" në Vushtrri, ku në finale u mposhtëm nga kombëtarja e Maqedonisë së Veriut.

Më 8 tetor - filloj Kampionati i Kosovës në Goalball, ku "KG. DRENICA", zhvilloj tri ndeshje, duke i fituar të gjitha.

Më 25 tetor - mbrojta me sukses vendin e parë në garën shtetërore të shkrim-leximit në Brajl.

Më 18 nëntor - organizuam Kampionatin e Kosovës në Goalball në qytetin e Skenderajt për herë të parë, ku edhe aty zhvilluam 3 ndeshje, e morëm po aq fitore.

Më 24 nëntor - mora pjesë në Selanik të Greqisë me Kombëtaren e Kosovës në Goalball, ku realizova 32 gola.

Më 3 dhjetor - morëm fitoren e parë me Kombëtaren e Kosovës në Futboll për të Verbër, ku dhe realizova 2 golat e parë me Kombëtaren dhe fituam turneun e Prishtinës.

Intervistat radio-televizive, trajnimet, udhëtimet dhe aktivitetet tjera nuk munguan as këtë vit.

"Ndërsa sukse si im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem." Thotë Shqiproni duke cituar Kuranin, Suren "Hud" 88. Dhe e përmbyll me fjalët: "Ndoshta pak u lodhët duke lexuar, por shpresoj që vitin e ardhshëm me ju ra me lexu edhe më shumë sepse nuk e bëj plan me u ndal". I urojmë Shqipronit që edhe në vitin 2024 të ketë shumë më shumë sukse se individuale, me ekipin e tij Drenica dhe me kombëtaren e Kosovës.